



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 10

31 janar 2026

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10:00 dhe mbaron në orën 13:00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	13 pikë	12 pikë	7 pikë	7 pikë	11 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....

2.....

1. Katër dokumentet e mëposhtme i referohen periudhës së Mesjetës. Duke analizuar këto dokumente përgjigjuni pyetjeve.

Dokumenti 1

Mesjeta ishte një periudhë themelore në formimin e Evropës, ku patën rëndësi strukturat mendore dhe kulturore që u krijuan gjatë kësaj kohe. Kjo epokë nuk duhet të konsiderohet si një ndërprerje midis Antikitetit dhe Modernitetit, por si një proces i gjatë transformimi. Mënyra se si njeriu mesjetar e konceptonte kohën, punën dhe besimin fetar ishte vendimtare për ndërtimin e identitetit evropian, duke e bërë Mesjetën një epokë krijuese dhe jo thjesht një periudhë tranzicioni.

Burimi: Le Goff, J. (2005). *The Birth of Europe*. Blackwell Publishing. Oksford

Dokumenti 2

Mesjeta, përmes marrëdhënieve shoqërore dhe strukturave të pushtetit, vendos në qendër sistemin feudal. Feudalizmi nuk ishte vetëm një organizim ekonomik, por një rrjet marrëdhëniesh personale të bazuara në besnikëri dhe detyrim. Për të kuptuar Mesjetën është e domosdoshme të studiohet jeta e përditshme, mendësia dhe mënyra se si njerëzit e përjetonin autoritetin.

Burimi: Bloch, M. (1961). *Feudal Society*. Chicago: University of Chicago Press.

Dokumenti 3

Ndarja e shoqërisë në mesjetë ishte në tre rinde: ata që luten, ata që luftojnë dhe ata që punojnë, ndarje kjo që legjitimon pabarazitë dhe shërben për të ruajtur stabilitetin shoqëror. Ky rend nuk ishte vetëm realitet shoqëror, por edhe një konstrukt mendor, i pranuar dhe i riprodhuar nga shoqëria mesjetare.

Burimi: Duby, G. (1980). *The Three Orders: Feudal Society Imagined*, Chicago: University of Chicago Press

Dokumenti 4

Mesjeta ishte një epokë që karakterizohej nga intensiteti emocional dhe simbolik. Jeta mesjetare ishte e mbushur me kontraste të forta mes besimit dhe frikës, devotshmërisë dhe dhunës. Kultura mesjetare ishte thellësisht simbolike, dhe mënyra se si njerëzit ndienin, besonin dhe imagjinonin botën është çelësi për të kuptuar këtë periudhë historike.

Burimi: Huizinga, J. (1997). *The Autumn of the Middle Ages*. Chicago: University of Chicago Press

- a) Krahasoni rolin e fesë në interpretimin e Mesjetës sipas katër autorëve. A paraqitet ajo më shumë si forcë kulturore, ideologjike apo shoqërore?

7 pikë

Përgjigje e saktë:

Roli i fesë në interpretimin e Mesjetës paraqitet ndryshe nga secili prej katër autorëve, duke reflektuar qasje të ndryshme historiografike ndaj kësaj periudhe. Megjithatë feja është e pranishme në analizat e të gjithëve, ajo nuk trajtohet në të njëjtin funksion, por shfaqet herë si forcë kulturore, herë si ideologjike dhe herë si shoqërore. Te Le Goff, feja paraqitet kryesisht si forcë kulturore dhe mendore. Ai e sheh besimin fetar si element që formëson mënyrën se si njeriu mesjetar e konceptonte kohën, punën, moralin dhe jetën e përditshme. Për Le Goff-in, feja nuk është vetëm institucion, por pjesë e mendësisë kolektive që ndërtoi identitetin evropian. Në këtë kuptim, roli i saj është më tepër kulturor sesa politik apo ekonomik.

Ndryshe nga kjo qasje, Bloch e trajton fenë më shumë si forcë shoqërore. Ai nuk e vendos fenë në qendër të analizës teologjike, por e sheh atë si element që ndikon marrëdhëniet mes njerëzve dhe legjitimon autoritetin. Në sistemin feudal, feja kontribuon në forcimin e besnikërisë, betimeve dhe rendit shoqëror. Për Bloch-in, besimi fetar ndihmon në funksionimin e strukturave shoqërore, por nuk është domosdoshmërisht burimi kryesor i tyre.

Për Duby-n, feja merr qartë funksion ideologjik. Ai argumenton se rendi shoqëror mesjetar justifikohet përmes diskursit fetar, duke e paraqitur ndarjen shoqërore si të vendosur nga Zoti. Në këtë mënyrë, feja shërbente për legjitimimin e pabarazive dhe për ruajtjen e stabilitetit të rendit feudal. Për Duby-n, feja nuk është vetëm besim, por instrument ideologjik që mban në këmbë strukturën shoqërore.

Ndërsa te Huizinga, feja shfaqet kryesisht si forcë simbolike dhe emocionale. Ai e sheh besimin si pjesë të botëkuptimit mesjetar, të mbushur me rituale, simbole, frikë dhe shpresë. Për Huizinga-n, feja ndikonte mënyrën se si njerëzit ndienin dhe përjetonin realitetin, duke e bërë kulturën mesjetare thellësisht simbolike dhe emocionale.

Feja nuk paraqitet në mënyrë të njëjtë nga këta autorë. Te Le Goff ajo është kryesisht kulturore, te Bloch shoqërore, te Duby ideologjike, ndërsa te Huizinga simbolike dhe emocionale. Kjo shumëllojshmëri interpretimesh tregon se feja ishte një element kompleks i Mesjetës, i cili nuk mund të kuptohet përmes një funksioni të vetëm, por vetëm përmes një analize të shumëanshme historiografike.

- b) Cili autor ofron interpretimin më kompleks të Mesjetës? Justifikoni zgjedhjen tuaj përmes krahasimit të qasjeve të historiografisë. **6 pikë**

Përgjigje e saktë:

Interpretimi më kompleks i Mesjetës ofrohet nga Le Goff, pasi qasja e tij arrin të bashkojë dimensionin shoqëror, kulturor dhe mendor të kësaj periudhe në një analizë të integruar historike. Ndryshe nga autorët e tjerë, Le Goff nuk e kufizon studimin e Mesjetës në një aspekt të vetëm, por e trajton atë si një proces të gjatë formimi historik.

Në krahasim me të, Bloch përqendrohet kryesisht në strukturat shoqërore dhe marrëdhëniet feudale. Kontributi i tij është themelor për të kuptuar organizimin e pushtetit dhe jetën e përditshme, por analiza e tij mbetet më shumë strukturore sesa kulturore. Bloch shpjegon si funksiononte shoqëria mesjetare, por më pak si ajo e përjetonte veten.

Duby, nga ana tjetër, e thellon analizën ideologjike të rendit mesjetar, duke treguar se si pabarazitë shoqërore justifikoheshin përmes diskursit fetar dhe simbolik. Megjithatë, qasja e tij është më e përqendruar në rendin shoqëror dhe mekanizmat e legjitimitetit, duke mos e shtrirë analizën në të gjithë përvojën kulturore të Mesjetës.

Ndërsa Huizinga ofron një interpretim të pasur në aspektin kulturor dhe emocional, duke e paraqitur Mesjetën si një botë simbolesh dhe ndjenjash të forta. Megjithatë, qasja e tij mbetet më shumë kulturore sesa shoqërore, duke mos i analizuar në mënyrë të plotë strukturat politike dhe ekonomike.

Në këtë krahasim, Le Goff dallohet sepse arrin të ndërthurë analizën e mendësisë, kohës, punës, fesë dhe strukturave shoqërore në një vizion të përbashkët. Ai e sheh Mesjetën jo si një epokë statike, por si një proces transformimi që lidh Antikitetin me Modernitetin. Pikërisht kjo aftësi për të bashkuar dimensione të ndryshme të historisë e bën interpretimin e tij më kompleks dhe më gjithëpërfshirës nga pikëpamja historiografike.

2. Në çfarë mase motivet civilizuese dhe fetare të imperializmit evropian shërbyen për të legjitimuar interesa ekonomike dhe politike?

Analizoni dokumentet duke theksuar kontradiktën midis praktikës dhe justifikimit ideologjik.

12 pikë

Dokumenti 1

Gjatë mbretërimit të perandorëve Kien-lung dhe Kia-king, këta barbarë anglezë u lutën me përlulësi për hyrje dhe për leje që të sillnin tribut dhe dhurata; më pas, me guxim të tepruar, kërkuan të merrnin Zhoushan (*një grup ishujsh pranë provincës Zhejiang në Kinën lindore*). Por sovranët tanë, duke e kuptuar qartë natyrën tradhtare të qëllimeve të tyre, ua refuzuan me vendosmëri. Që prej asaj kohe, duke u lidhur me tregtarë kinezë tradhtarë, ata kanë zhvilluar një tregti të madhe dhe kanë helmuar popullin tonë trim me opium.

Me të vërtetë, barbarët anglezë vrasin këdo që munden. Ata janë si qen, dëshirat e të cilëve nuk kënaqen kurrë. Prandaj nuk kemi pse të pyesim nëse paqja që kanë bërë tani është e vërtetë apo e rreme. Le të ngrihemi të gjithë, të armatosemi, të bashkohemi dhe të luftojmë kundër tyre.

Burimi: Dokument i miratuar në një mbledhje të madhe publike në Kanton, Kinë, "Populli i Kantonit: Kundër anglezëve", 1842

Dokumenti 2

Çështja e ndërhyrjes së qeverisë në kolonizim përfshin interesat e ardhshme dhe të përhershme të vetë civilizimit dhe shkon shumë përtej kufijve të ngushtë të konsideratave thjesht ekonomike. Por edhe duke e parë vetëm nga ky këndvështrim, zhvendosja e popullsisë nga zonat e mbipopulluara në pjesët e pabanuara të sipërfaqes së Tokës është një nga veprat me dobi të jashtëzakonshme shoqërore, e cila kërkon më shumë dhe shpërblen më mirë ndërhyrjen e qeverisë. Për të vlerësuar përfitimet e kolonizimit, duhet parë jo në lidhje me një vend të vetëm, por me interesat ekonomike kolektive të racës njerëzore. Kjo çështje trajtohet shpesh vetëm si problem shpërndarjeje të punës, por ajo është gjithashtu një çështje prodhimi dhe e përdorimit më efikas të burimeve prodhuese të botës.

Burimi: John Stuart Mill, Mbi kolonitë dhe kolonizimin, 1848

Dokumenti 3

Trembëdhjetë ishuj të këtij grupi, ku jeta dhe prona tani janë relativisht të sigurta, 8 000 të krishterë të shpallur dhe të gjitha kishat e ngritura janë, me bekimin e Zotit, fryt i punës së misionarëve britanikë...Ne shpresojmë dhe lutemi që Britania e Madhe të marrë sa më shpejt në zotërim Hebridet e Reja. Qoftë nga këndvështrimi i njerëzimit, i krishterimit, i tregtisë apo i politikës, është shumë e dëshirueshme që ato të bëhen pronë britanike.

Burimi: Letër e misionarit britanik John G. Paton, Misioni i Hebrideve të Reja, 1883

Dokumenti 4

Politika e zgjerimit kolonial është një sistem politik dhe ekonomik... i lidhur me idetë ekonomike, me idetë e civilizimit dhe me idetë politike e patriotike. Racat e larta kanë të drejtë mbi racat e ulëta sepse kanë detyrën për t'i civilizuar ato. Të mos marrësh pjesë në zgjerimin kolonial do të thotë të abdikosh nga madhështia kombëtare.

Burimi: Jules Ferry, Fjalim para Dhomës së Deputetëve Francezë, 28 mars 1884

Dokumenti 5

Misionet mjekësore dhe industriale janë më të dobishmet në fazat e para të zhvillimit të popujve "të egër". Ato zëvendësojnë magjinë dhe besëtytnitë, rrisin produktivitetin bujqësor dhe krijojnë teprica, duke i bërë vendasit pjesë të ekonomisë tregtare dhe duke rritur "qytetërimin" e tyre.

Burimi: Kapiten F. D. Lugard, Ngritja e Perandorisë sonë të Afrikës Lindore, 1893

Dokumenti 6

Në emër të civilizimit: Arsimi, si për meshkuj ashtu edhe për femra. Edhe pse ende i pjesshëm, ai është një bekim i paçmueshëm dhe çon gradualisht në shkatërrimin e besëtytnive dhe shumë të këqijave morale e shoqërore.

Ringjallja e letërsisë fisnike indiane, e përshtatur dhe e rafinuar nga ndriçimi i Perëndimit.

Politikisht: Paqe dhe rend. Liri fjale dhe liri shtypi. Njohuri dhe aspirata më të larta politike. Përmirësim i qeverisjes në shtetet vendase. Siguri e jetës dhe pronës. Liri nga shtypja e sundimtarëve despotikë dhe nga shkatërrimet e luftës. Drejtësi e barabartë (ndonjëherë e cënuar nga favorizimi i evropianëve). Shërbime të administratorëve shumë të arsimuar.

Materialisht: Hua për hekurudha dhe ujtje. Zhvillimi i disa produkteve të vlefshme si indigo, çaj, kafe, mëndafsh etj. Rritje e eksporteve. Telegrafë...

Në përmbledhje: Sundimi britanik ka qenë moralisht një bekim i madh; politikisht paqe dhe rend nga njëra anë, gabime nga ana tjetër; materialisht varfërim, i lehtësuar pjesërisht nga huatë për hekurudha. Vendasit e quajnë sistemin britanik "Sakar ki Churi" – thika e sheqerit: e ëmbël në dukje, por thikë gjithsesi.

Burimi: Dadabhai Naoroji, "Përfitimet e sundimit britanik", 1871

Përgjigje e saktë:

Imperializmi evropian u ushqye nga interesa ekonomike konkrete, por u legjitimua dhe u mbështet publikisht përmes justifikimeve kulturore dhe morale, duke krijuar një kontradiktë të vazhdueshme midis motiveve reale dhe "veshjes" ideologjike të problemit. Dokumentet tregojnë se, ndonëse zgjerimi kolonial synonte përfitime ekonomike dhe strategjike, ai u paraqit kryesisht si një mision civilizues, fetar dhe moral, i nevojshëm për përparimin e popujve të kolonizuar.

Nga njëra anë, motivet reale ekonomike janë të pranishme në disa dokumente. Kështu, ekonomisti i njohur John Stuart Mill e sheh kolonizimin si një mjet për të rritur efikasitetin e sistemit ekonomik kapitalist, përmes shpërndarjes së popullsisë (dërgimit të kolonëve në territoret koloniale) dhe përdorimit më racional të burimeve (shfrytëzim i burimeve të kolonive). Nga ana tjetër, Lugard lidh ndërhyrjen koloniale me rritjen e prodhueshmërisë në sektorin bujqësor dhe integrimin e ekonomive koloniale në tregjet botërore. Edhe Jules Ferry pranon se politikat koloniale lidhen me interesa ekonomike dhe konkurrencën në nivel kombëtar. Këto burime mbështesin tezën se ekonomia ishte një shtysë reale për tendencën imperialiste për kapjen e kolonive.

Megjithatë, këto interesa ekonomike rrallë paraqiten si qëllimi kryesor në qasjen publike. Përkundrazi, dokumentet tregojnë se imperializmi u justifikua kryesisht përmes argumenteve kulturore. Jules Ferry e përkufizon imperializmin si detyrë morale të "racave të larta" për të civilizuar "racat inferiore", duke zhvendosur vëmendjen nga përfitimi material drejt një misioni etik. Në të njëjtën linjë, misionari John G. Paton argumenton se aneksimi kolonial ishte i domosdoshëm për përhapjen e krishtëritimit dhe për "humanizmin", ndërsa Lugard i paraqet misionet mjekësore dhe industriale si mjete për të zhdukur "besëtytnitë" dhe për të çuar përpara

shoqëritë vendase. Në këto raste, kultura dhe feja shërbejnë si mbulesë morale për zgjerimin politik dhe ekonomik.

Kontradikta midis motiveve dhe justifikimeve bëhet edhe më e dukshme në dokumentin e Dadabhai Naoroji. Ai tregon se, pavarësisht retorikës së zhvillimit dhe përparimit, sundimi britanik çoi në varfërim për Indinë nga pikëpamja ekonomike. Kjo sugjeron se justifikimi civilizues nuk përputhej me pasojat reale dhe ndikimin në ekonomi, duke nxjerrë në pah natyrën shfrytëzuese të imperializmit.

Edhe reagimi i popullit të Kantonit e nxjerr në pah këtë kontradiktë. Britanikët denoncohen jo vetëm për shfrytëzim ekonomik (tregtia e opiumit), por edhe për cënimin e rendit moral dhe shoqëror kinez. Kjo tregon se imperializmi perceptohej nga të kolonizuarit si një imponim i dyfishtë: material dhe kulturor, pavarësisht se ai paraqitej nga evropianët si përparim.

Pra, duhet thënë se dokumentet tregojnë se interesat ekonomike ishin shpesh motivi real i imperializmit evropian, por justifikimet kulturore dhe morale ishin mjeti kryesor për ta legjitimuar atë. Kjo kontradiktë midis asaj që kërkohej në praktikë dhe asaj që shpallej në publik, shpjegon pse imperializmi mundi të mbijetojë si në rastin kur përfitimet ekonomike ishin të diskutueshme, ashtu edhe kur pasojat për popullsitë vendase ishin shpesh negative.

3. Revolucioni i parë dhe i dytë industrial përfaqësojnë dy momente kyçe në historinë e Evropës, ku transformimet teknologjike dhe organizative ndryshuan rrënjësisht strukturën ekonomike dhe shoqërore. Këto procese jo vetëm që nxitën inovacionin dhe rritën prodhimin, por edhe hodhën themelet e kapitalizmit modern, duke përcaktuar mënyrën se si shoqëritë evropiane u zhvilluan në shekujt pasues.

- a) Analizoni ndikimin e revolucionit të parë dhe të dytë industrial në transformimin ekonomik dhe shoqëror të Evropës, duke theksuar ndryshimet kryesore në natyrën e inovacionit teknologjik, organizimin e prodhimit dhe rolin e tyre në ndërtimin e kapitalizmit modern.

3 pikë

(Argumentoni përgjigjen tuaj duke analizuar dokumentet e mëposhtme)

Dokumenti 1

Revolucioni i parë industrial, i cili filloi në Britaninë e Madhe në fund të shekullit XVIII (rreth viteve 1760–1840), shënoi kalimin nga prodhimi artizanal drejt prodhimit mekanik. Ky revolucion u karakterizua nga përdorimi i makinave me avull, zhvillimi i industrisë tekstile dhe rritja e fabrikave, duke ndryshuar rrënjësisht strukturën ekonomike dhe shoqërore. Si pasojë, u rrit urbanizimi, u krijua klasa punëtore industriale dhe u përshpejtua ndarja e punës, duke vendosur themelet e kapitalizmit modern.

Burimi: Hobsbawm, E. J. (1962). The Age of Revolution: Europe 1789–1848. London: Weidenfeld & Nicolson.

Dokumenti 2

Revolucioni i dytë industrial, që u zhvillua nga fundi i shekullit XIX deri në fillim të shekullit XX, u karakterizua nga përparime të mëdha teknologjike si përdorimi i energjisë elektrike, zhvillimi i industrisë kimike, prodhimi masiv i çelikut dhe lindja e linjave të montimit. Ky revolucion rriti ndjeshëm produktivitetin industrial, forcoi korporatat e mëdha dhe përshpejtoi globalizimin ekonomik. Ndryshimet teknologjike ndikuan edhe në jetën sociale, arsimin dhe organizimin e punës, duke krijuar bazën e shoqërisë industriale moderne.

Burimi: Mokyr, J. (1990). The Lever of Riches: Technological Creativity and Economic Progress. New York: Oxford University Press.

Përgjigje e saktë:

Revolucioni i parë industrial shënoi një pikë kthese historike në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Evropës, duke sjellë kalimin nga prodhimi bujqësor dhe artizanal drejt prodhimit industrial të mekanizuar. Futja e makinave me avull, zhvillimi i industrisë tekstile dhe ndërtimi i fabrikave ndryshuan mënyrën tradicionale të punës dhe krijuan një ekonomi të bazuar në prodhim masiv. Si pasojë, u rrit urbanizimi, u formua klasa punëtore industriale dhe u thellua ndarja e punës, duke sjellë ndryshime të mëdha në strukturën sociale.

Revolucioni i dytë industrial, nga ana tjetër, nuk përfaqësonte vetëm vazhdimësi, por edhe një fazë të re të industrializimit. Ai u karakterizua nga përdorimi i energjisë elektrike, zhvillimi i industrisë kimike, prodhimi i çelikut dhe aplikimi i linjave të montimit. Këto risi rritën ndjeshëm produktivitetin dhe mundësuan prodhimin në shkallë shumë më të gjerë. Ndryshe nga revolucioni i parë, i cili u përqendrua kryesisht në mekanizim, revolucioni i dytë solli racionalizimin e prodhimit dhe organizimin shkencor të punës.

Dallimi kryesor midis dy revolucioneve qëndron në natyrën e inovacionit: i pari hodhi themelet e industrializimit, ndërsa i dyti e përmirësoi, e modernizoi dhe e shndërroi atë në një sistem global ekonomik. Së bashku, këto dy procese ndërtuan bazat e kapitalizmit modern dhe shoqërisë industriale evropiane.

- b) Vlerësoni rolin e revolucionit të parë dhe të dytë industrial në formimin e shoqërisë moderne, duke analizuar pasojat e tyre afatgjata ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe ndikimin që këto procese historike vazhdojnë të kenë në zhvillimet bashkëkohore. **4 pikë**

- Pasojat ekonomike

Përgjigje e saktë:

Revolucionet industriale sollën një transformim rrënjësor të ekonomisë evropiane, duke shënuar kalimin nga ekonomia bujqësore drejt ekonomisë industriale. Mekanizimi i prodhimit, përdorimi i teknologjive të reja dhe zhvillimi i fabrikave rritën ndjeshëm produktivitetin dhe kapacitetin prodhues. Këto procese çuan në konsolidimin e kapitalizmit industrial, krijimin e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në përshejtimin e globalizimit ekonomik. Po ashtu, u forcua roli i sipërmarrjes private dhe u krijuan korporata të mëdha industriale që dominuan ekonominë moderne.

- Pasojat sociale

Përgjigje e saktë:

Në planin social, revolucionet industriale ndryshuan strukturën e shoqërisë duke krijuar klasa të reja shoqërore, veçanërisht klasën punëtore industriale dhe borgjezinë. Urbanizimi masiv solli rritjen e qyteteve, por edhe probleme sociale si varfëria urbane, kushtet e vështira të punës dhe pabarazitë shoqërore. Si reagim ndaj këtyre sfidave u zhvilluan lëvizjet sindikale, u kërkuar të drejta për punëtorët dhe u vendosën reformat sociale, të cilat përbëjnë sot bazën e shtetit social dhe të legjislacionit modern të punës.

- Pasojat kulturore

Përgjigje e saktë:

Revolucionet industriale ndikuan edhe në dimensionin kulturor dhe mënyrën e të menduarit shoqëror. Ato nxitën përhapjen e arsimit, veçanërisht arsimit teknik dhe profesional, si dhe rritën besimin në shkencë, racionalitet dhe progres teknologjik. Ndryshimet në ritmin e jetës, në organizimin e kohës së punës dhe në marrëdhëniet njerëzore transformuan kulturën tradicionale. Kjo periudhë kontribuoi në formimin e kulturës moderne urbane dhe në zhvillimin e ideve mbi modernizimin, përparimin dhe inovacionin.

- Ndikimi në zhvillimet bashkëkohore

Përgjigje e saktë:

Proceset historike të nisura gjatë revolucionit të parë dhe të dytë industrial vazhdojnë të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet bashkëkohore ekonomike, sociale dhe teknologjike. Modelet e prodhimit industrial, ndarja e punës dhe organizimi racional i ekonomisë përbëjnë ende bazën e sistemeve moderne të prodhimit. Varësia nga teknologjia, inovacioni i vazhdueshëm dhe konkurrenca globale janë pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre revolucioneve historike. Konceptet e të drejtave të punës, arsimit profesional dhe shtetit social lidhen ngushtë me reagimet ndaj pasojave të industrializimit. Po ashtu, urbanizimi, migrimi drejt qyteteve dhe transformimi i marrëdhënieve të punës vazhdojnë të jenë sfida aktuale të shoqërive moderne. Ideja e progresit, modernizimit dhe besimit në zhvillimin teknologjik mbetet një element qendror i mendësisë bashkëkohore, duke dëshmuar se revolucionet industriale nuk janë vetëm ngjarje historike, por procese që vazhdojnë të formësojnë botën e sotme.

4. Krahasoni dhe vlerësoni mënyrat se si u realizua bashkimi i Italisë dhe i Gjermanisë në shekullin XIX. Në çfarë mase këto procese u udhëhoqën nga nacionalizmi liberal dhe në çfarë mase nga politika e fuqisë (realpolitik)? (Argumentoni përgjigjen tuaj duke analizuar dokumentet e mëposhtme) **7 pikë**

Dokumenti 1 – Italia

"Italia nuk do të bëhet kurrë komb i vërtetë pa ndërgjegje morale dhe pa pjesëmarrjen aktive të popullit. Kombet nuk ndërtohen nga mbretërit, por nga qytetarët."

Burimi: Giuseppe Mazzini, Detyrat e njeriut, 1844

Dokumenti 2 – Italia

"Italia do të bashkohet jo përmes ëndrrave revolucionare, por përmes diplomacisë së mençur, aleancave ndërkombëtare dhe forcimit të shtetit."

Burimi: Camillo di Cavour, fjalim në parlamentin e Piemont-Sardenjës, 1858

Dokumenti 3 – Gjermania

"Një komb është i bashkuar nga gjuha, kultura dhe kujtesa e përbashkët historike."

Burimi: Johann Gottfried Herder, Ide mbi filozofinë e historisë së njerëzimit, fund i shek. XVIII (përdorur gjerësisht në shek. XIX)

Dokumenti 4 – Gjermania

"Çështjet e mëdha të kohës nuk zgjidhen me fjalime dhe vota shumice, por me hekur dhe gjak."

Burimi: Otto von Bismarck, fjalim para parlamentit prusian, 1862

Dokumenti 5 – Perspektivë krahasuese

"Bashkimi i Gjermanisë ishte produkt i fuqisë shtetërore dhe luftës së qëllimshme, ndërsa bashkimi i Italisë ishte më i fragmentuar dhe i varur nga rastësitë dhe ndërhyrjet e jashtme."

Burimi: A. J. P. Taylor, The Struggle for Mastery in Europe, 1954

Përgjigje e saktë:

Bashkimi i Italisë dhe ai i Gjermanisë në shekullin XIX u zhvilluan në kontekstin e Evropës pas Kongresit të Vjenës (1815), ku rendi konservator përqipë të frenonte nacionalizmin dhe liberalizmin. Edhe pse të dy proceset u ushqyen nga ide nacionaliste dhe synimi për shtet-komb, mënyrat e realizimit të bashkimit ndryshuan ndjeshëm. Ndërsa bashkimi i Italisë ishte një proces i përzier mes nacionalizmit liberal dhe diplomacisë pragmatike, bashkimi i Gjermanisë u realizua kryesisht përmes real-politikës dhe fuqisë shtetërore të Prusisë.

Në të dy rastet, nacionalizmi ideologjik luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e ndërgjegjes kombëtare. Në Itali, Giuseppe Mazzini theksonte se kombi duhej të ndërtohej mbi pjesëmarrjen aktive të popullit dhe mbi ideale morale e republikane, duke e lidhur bashkimin me nacionalizmin liberal. Po ashtu, në hapësirën gjermane, mendimtarë si Johann Gottfried Herder e përkufizonin kombin si një bashkësi të bazuar në gjuhë, kulturë dhe histori të përbashkët. Këto ide krijuan bazën kulturore të nacionalizmit, por në të dy vendet rezultuan të pamjaftueshme për të realizuar bashkimin politik pa mbështetje shtetërore.

Dallimet kryesore shfaqen në mënyrën se si këto ide u shndërruan në realitet politik. Në Itali, përpjekjet revolucionare të Mazzinit dhe kryengritjet popullore dështuan në mënyrë të përsëritur, duke treguar kufijtë e nacionalizmit liberal. Si reagim ndaj këtyre dështimeve, Camillo di Cavour ndoqi një strategji pragmatike, duke përdorur diplomacinë, aleancat ndërkombëtare dhe luftën e kufizuar për të zgjeruar ndikimin e Mbretërisë së Piemont-Sardenjës. Bashkimi italian, pra, ishte rezultat i një kompromisi mes idealizmit liberal dhe interesave monarkike, duke e bërë procesin të fragmentuar dhe të varur nga faktorë të jashtëm si Franca dhe rënia e Perandorisë Austriake.

Ndryshe nga Italia, bashkimi i Gjermanisë u realizua kryesisht përmes real-politikës të drejtuar nga Otto von Bismarck. Në fjalimin e tij të famshëm për "hekur dhe gjak", Bismarck e përjashtoi qartë nacionalizmin parlamentar dhe liberal si mjet për bashkim, duke theksuar rolin vendimtar të forcës ushtarake dhe diplomacisë shtetërore. Përmes tre luftërave të suksesshme (kundër Danimarkës, Austrisë dhe Francës), Prusia arriti të eliminojë rivalët dhe të bashkojë shtetet gjermane nën dominimin e saj. Kjo tregon se bashkimi i Gjermanisë ishte më i centralizuar, më i kontrolluar dhe më pak i varur nga mobilizimi popullor sesa ai italian.

Taylor e përforcon këtë krahasim, duke argumentuar se bashkimi i Gjermanisë ishte produkt i fuqisë shtetërore dhe planifikimit strategjik, ndërsa ai i Italisë ishte më i paqëndrueshëm dhe i ndikuar nga rrethanat ndërkombëtare. Ky vlerësim ndihmon në kuptimin e pasojave afatgjata: Gjermania doli nga bashkimi si një fuqi e fortë ushtarake dhe industriale, ndërsa Italia mbeti një shtet i bashkuar politikisht, por i dobët ekonomikisht dhe i përçarë shoqërisht.

Edhe pse bashkimi i Italisë dhe Gjermanisë u ushqyen nga ide të ngjashme nacionaliste, thelbi dhe mënyrat e realizimit të tyre ndryshuan në mënyrë domethënëse. Bashkimi italian përfaqëson një ndërthurje të

nacionalizmit liberal me pragmatizmin diplomatik, ndërsa bashkimi gjerman ishte kryesisht rezultat i real-politikës dhe fuqisë shtetërore. Këto dallime jo vetëm shpjegojnë rrugët e ndryshme drejt shtet-kombit, por edhe ndikuan thellësisht në rolin që këto dy vende do të luanin në historinë evropiane të shekujve pasues.

5. Vlerësoni deri në çfarë mase konfliktet e Luftës së Ftohtë pas vitit 1945 pasqyruan konkurrencën ideologjike midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik përmes luftërave "me ndërmjetës" (proxy wars), dhe jo përmes përballjes së drejtpërdrejtë ushtarake. Identifikoni shembuj konkretë.
(Argumentoni përgjigjen tuaj duke analizuar dokumentet e mëposhtme)

11 pikë

Dokumenti 1

"Personaliteti politik i fuqisë sovjetike, ashtu siç e njohim sot, është produkt i ideologjisë dhe rrethanave... fuqia sovjetike është e papërshkueshme nga logjika e arsyes, por shumë e ndjeshme ndaj logjikës së forcës."

Burimi: George F. Kennan, *Telegrami i Gjatë*, 1946

Dokumenti 2

"Bashkimi Sovjetik udhëhiqet nga një besim i ri fanatik, thelbësisht kundër vlerave tona... Bota e lirë duhet të përgjigjet me një ndërtim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të fuqisë politike, ekonomike dhe ushtarake."

Burimi: NSC-68, Raport i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, 1950

Dokumenti 3

"Imperialistët janë agresivë nga natyra... Nëse nuk luftojmë tani, do të detyrohemi të luftojmë më vonë në kushte më të këqija."

Burimi: Mao Ce Duni (Mao Zedong), *Fjalim mbi Luftën Koreane*, 1950

Dokumenti 4

"Kuba nuk është satelit i askujt... por ne nuk do t'i nënshtrohemi dominimit imperialist, pavarësisht çmimit."

Burimi: Fidel Castro, *Fjalim në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së*, 1960

Dokumenti 5

"Përdorimi ose kërcënimi me forcë nuk mund të jetë më instrument i politikës së jashtme... bota është e ndërlidhur."

Burimi: Mikhail Gorbaçov, *Fjalim në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së*, 1988

Përgjigje e saktë:

Lufta e Ftohtë u karakterizua nga një rivalitet intensiv ideologjik midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik, por rrallëherë u shndërrua në përballje të drejtpërdrejtë ushtarake mes dy superfuqive. Në vend të kësaj, konflikti u shpreh kryesisht përmes luftërave me ndërmjetës në pjesë të ndryshme të botës. Analiza e dokumenteve tregon se konkurrenca ideologjike, frika nga përshkallëzimi bërthamor dhe strategjia gjeopolitike e bënë konfliktin, indirekt, formën dominuese të Luftës së Ftohtë.

Që në fillim, mendimi strategjik amerikan theksoi përmbajtjen dhe jo luftën e drejtpërdrejtë. *Telegrami i Gjatë* i George Kennan e përshkruan sjelljen sovjetike si ideologjike dhe rezistente ndaj kompromisit, por gjithashtu sugjeron se rezistenca e vendosur do ta kufizonte zgjerimin e saj. Ky arsyetim çoi SHBA-në të kundërshtonte komunizmin kudo që shfaqej, pa provokuar një luftë botërore. Qasja ishte që Lufta e Ftohtë të ishte një përballje globale ideologjike që kërkonte mobilizim ushtarak dhe ekonomik por duke evituar përplasjen direkte.

"Luftërat me ndërmjetës" u formësuan gjithashtu nga aktorë rajonalë që vepronin sipas interesave të tyre. Ndërhyrja kineze në Luftën e Koresë, e justifikuar nga Mao Ce Duni si një domosdoshmëri për t'u mbrojtur nga imperializmi, tregon se si konfliktet lokale u lidhën me rivalitetin global. Edhe pse Lufta e Koresë ishte jashtëzakonisht e dhunshme, ajo mbeti një konflikt me ndërmjetës sepse as SHBA-ja dhe as BRSS-ja nuk synuan luftë të drejtpërdrejtë, për shkak të rrezikut bërthamor.

Në Amerikën Latine, Lufta e Ftohtë u reflektua përmes përplasjeve indirekte dhe revolucioneve. Fjalimi i Fidel Castros thekson refuzimin e dominimit amerikan dhe tregon se si regjimet revolucionare u rreshtuan me bllokun sovjetik duke ruajtur një frymë nacionaliste. Kriza e Raketave Kubane nxori në pah rrezikun ekstrem të përshkallëzimit, por njëkohësisht përforcoi nevojën për shmangien e konfliktit të drejtpërdrejtë.

Fakti që Lufta e Ftohtë u zhvillua kryesisht përmes luftërave me ndërmjetës lidhet ngushtë me ekzistencën e armëve bërthamore. Doktrina e shkatërrimit të ndërsjellë të sigurt (MAD) e bëri luftën të drejtpërdrejtë mes superfuqive pothuajse të paimagjinueshme. Kjo logjikë reflektohet në fjalimin e Mikhail Gorbaçovit në vitin

1988, ku ai mohon përdorimin e forcës si mjet të politikës së jashtme dhe pranon ndërvlerësinë globale. Ky qëndrim sinjalizoi fundin e Luftës së Ftohtë dhe rënien graduale të konflikteve me ndërmjetës.

Parë në tërësi, dokumentet mbështetin tezën se Lufta e Ftohtë u shpreh kryesisht përmes “luftërave me ndërmjetës” dhe jo përmes përballjes së drejtpërdrejtë ushtarake. Rivaliteti ideologjik ofroi justifikimin, armët bërthamore vendosën kufijtë, ndërsa konfliktet rajonale u shndërruan në arena konkurrimi. Megjithatë këto luftëra shkaktuan shkatërrime të mëdha në Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine, ato nxjerrin në pah paradoksin qendror të Luftës së Ftohtë: një konflikt global i përkufizuar nga përmbajtja dhe vetëpërmbajtja e superfuqive.